

**Raporti i Audituesit të Pavarur mbi Angazhimet
e Audituesit për Qëllime të Veçanta**

“PARTIA ALEANCA ARBNORE KOMBETARE “, Tiranë
Rruga “Besa “ Numur 55 , afër Tv ALSAT, Tiranë

**Raporti i audituesit të panvarur
Mbi përdorimin e Fondeve të përfituara,
Për Fushatën Zgjedhore të 8 Majit 2011
Për Zgjedhjet në Organet e Qeverisjes Vendore.**

1

Audituesi

Margarita GJERGJI

Adresa : Rruga e “ Durrësit “ Pallati 124/3/24
Tiranë – Albania

PERMBAJTJA

- Raporti i Audituesit të Panvarur
- Deklaratat Financiare
- Shenime për pasqyrat financiare
- Opinioni

RAPORTI I AUDITUESIT TE PANVARUR

DREJTUAR :

1. Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve;

Adresa : Pallati i Kongreseve
Tiranë

2. Partisë Aleanca Arbnore Kombëtare

Adresa : Rruga " Besa " numur 55 , afër Tv ALSAT
Tiranë

2

Të nderuar zotërinj,

Duke ju falenderuar për besimin që na dhatë duke na përzgjedhur për të kryer kontrollin ligjor mbi përdorimin e fondeve të përfituara gjatë fushatës zgjedhore të Partisë Aleanca Arbnore Kombëtare , Tiranë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, me anë të këtij relacioni kam nderin t'ju paraqes raportin tim " Mbi auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara , për fushatën zgjedhore të 8 Majit 2011 për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore."

Kontrolli është kryer mbi bazën e testimit të dokumentacionit të përdorur dhe të gjetur në zyrat e subjektit zgjedhor për transaksionet ekonomiko – financiare të kryera gjatë fushatës zgjedhore dhe që gjejnë pasqyrim në shumat e paraqitura në llogaritë financiare (Bilanci dhe anekset e tij).

Për përmbushjen e misionit tim , kam vlerësuar metodat dhe parimet e përdorura për mbajtjen e kontabilitetit si edhe të paraqitjes së deklarimeve financiare.

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare është përgjegjësi e Drejtimit të subjektit zgjedhor , Përgjegjësia ime është që bazuar në auditimin e kryer , të shpreh një opinion mbi këto pasqyra financiare. Unë besoj se auditimi i kryer jep një bazë të arësyeshmë për opinionin.

1. PASQYRAT FINANCIARE

Kontrolli i bilancit financiar në përgjithësi :

- Δ njohjen e Subjektit zgjedhor , (dokumentat ligjorë dhe ekonomike. Aktiviteti i zgjerimit të tij në rrethet e tjera.)
- Δ rakordimin me të dhënat e kontabilitetit.
- Δ reflektimin në mënyrë besnike të gjëndjes financiare të subjektit deri në datën 08 Maj 2011.
- Δ paraqitjen në përputhje me Legjislacionin Shqiptar “ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.”
- Δ marrjen parasysht të ngjarjeve me rëndësi të veçantë që kanë ndodhur pas datës 08 Maj 2011.

1.1 Baza ligjore.

Për kontrollin e të dhënave financiare u bazova në dispozitat ligjore në fuqi:

- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit me referencë të veçantë SNA 800.
- Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 “ Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë “.
- Ligjin nr.10091 datë 05.03.2009 “ Për auditimin ligjor,organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Rregjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar.”
- Ligjit nr.9228 datë 29.04.2004 “ Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare “.
- Si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre dhe, çdo dokument tjetër të marrë pranë Partisë Aleanca Arbnore Kombetare.

Situata financiare e paraqitur nga subjekti në Pasqyrat Financiare mendoj se rakordojnë me të dhënat e kontabilitetit dhe paraqesin në mënyrë besnike gjëndjen e subjektit deri në datën 08 Maj 2011.

1.2 Statusi i subjektit.

“ Partia Aleanca Arbnore Kombetare “ është krijuar mbi bazën e ligjit numur 8560 datë 17.02.2000 “ Për Partitë Politike “, rregjistruar si person juridik me vendimin numur 9760 numur rregjistri themeltar 15267 datë 17.12.2010 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë me emërtimin Partia Aleanca Arbnore Kombëtare me **Kryetar z.Gjet NDOJ**. Kjo parti nuk është e rregjistruar në organet tatimore.

Drejtimi i partisë bëhet nga Kryesia e Partisë.
Administrimi i saj bëhet nga Kryetari i Partisë.

1.3 Auditimi i deklaratve financiare të parashikuara nga ligji.

- Auditimin dhe sinqeritetin e informacioneve të tipit kontabël që figurojnë në raportin e drejtimit e kam kryer në zbatim të ligjit numur 10019 datë 29.12.2008 “ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë “ e më konkretisht në këto drejtime:

1. Zbatimi i nenit nr.87 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë “.

Nga auditimi që u krye në zbatim të këtij neni rezultoi se për periudhën e kontrolluar subjekti zgjedhor nuk kishte përfituar fonde publike e për rrjedhojë nuk i nënshtrohet detyrimit për kthimin e fondeve në zbatim të pikës nr.3 të nenit nr.87 , (deklarata e subjektit). Gjithashtu nga ana ime u verifikuan këto të dhëna edhe në çeljet e fondeve të kryera nga Ministria e Financve për llogari të subjektit zgjedhor.

2. Zbatimi i nenit nr.88 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë “.

Nga të dhënat që mu vunë në dispozicion të auditimit rezultoi se për periudhën e kontrolluar nuk rezultuan fonde publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale që të mund të përdreshin ose të viheshin në mbështetje të kandidatit , të subjektit zgjedhor. Kjo është e vërtetuar nga subjekti me deklaratën e datës 20.12.2011.

3. Zbatimi i nenit nr.89 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë “.

Nga auditimi që ju krye formës dhe përmbajtjes së informacioneve specifike rezultoi se, për fushatën zgjedhore subjekti nuk kishte përfituar fonde jo publike nga persona fizikë ose juridikë vendas, që të kenë kaluar kufirin 100.000 lekë, duke respektuar në këtë mënyrë pikën nr.2 të nenit nr.89 të ligjit. Gjithashtu nga verifikimi nuk rezultoi që subjekti të ketë përfituar fonde nga persona juridikë apo çdo aksioner i tij, sipas kufizimeve të përcaktuara në pikën nr.3 gërma (a,b,c,ç) të nenit nr.89 të ligjit. (deklarata e subjektit).

4. Nga auditimi që ju krye formës dhe përmbajtjes së informacioneve specifike rezultoi se në gjëndjen financiare dhe llogaritë e subjektit zgjedhor ka sinqeritet dhe paraqitje korrekte të tyre. Nuk ka ndonjë parregullsi, pasaktësi apo shkelje të konstatuara në zbatim të parimeve të normave kontabël, dispozitave e statutit të subjektit. Nuk ka ndonjë ngjarje ose informacion të rastit që të ketë ndikim në deklaratimet financiare të subjektit zgjedhor.

5. Auditimi i fondeve të përfituara nga kuotat e anëtarësisë.

4

Në zbatim të ligjit nr.8560 datë 17.02.2000 “ Për Partitë Politike “ anëtarët e partisë derdhen kuota anëtarësie në përputhje me ligjin , të cilat përdoren për shpenzimet e subjektit. Nga auditimi që ju krye zbatimit të ligjit dhe statutit të partisë mbi bazën e dokumentave që na u afruan dhe investigimeve me to nuk rezultoi që ndonjë anëtar të ketë derdhur kuota apo të jetë përdorur në favor të subjektit zgjedhor.

Nga ana ime nuk ka ndonjë vërejtje.

Në përfundim të verifikimeve dhe kontroleve, jam në gjëndje të vërtetoj se deklaratat e informacionit financiar që i aneksohen këtij raporti janë të sinqerta dhe të rregullta dhe japin një pamje besnike të situatës financiare dhe gjëndjes pasurore te Subjektit zgjedhor në datën 08 Maj 2011

Audituesi

Margarita GJERGJI

Tiranë , Janar 2012

Adresa : Rruga e “ Durrësit “ Pallati I24/3/24
Tiranë – Albania

“PARTIA ALFANCA ARBNORE KOMBETARE “ RAPORTI DHE PASQYRAT FINANCIARE
REPORT AND FINANCIAL STATEMENTS

